




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH .nr. 868/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik: OE “Joos&Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik: “N.SH.T.VIKTORY COM & Company Murseli SH.P.K”- Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës së Radoniqit-Kontratë tri vjeçare” me nr. të prok:632-19-2013-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë, më datën: 18.12.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Joos&Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës së Radoniqit-Kontratë tri vjeçare” me nr. të prok:632-19-2013-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës së Radoniqit-Kontratë tri vjeçare” me nr. të prok:632-19-2013-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Joos&Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE “Joos&Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 03.12.2019 me nr. 868/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës së Radoniqit-Kontratë tri vjeçare” me nr. të prok:632-19-2013-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 7, 24, 28, 52, 56, 59, 60, 69, 80 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 06.12.2019, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 12.12.2019, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim: Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 7, par. 2 i nenit 24, neni 56, par. 1, 2 dhe 4 i nenit 59, neni 60 dhe par. 6 i nenit 108/A të LPP-së, me arsyetimin se: “Me dt: 04.11.2019 jemi njoftuar nga AK Komuna e Gjakovës se ne si operator ekonomik jemi të pa suksesshëm. Autoriteti kontraktues ka rekomanduar për dhënie të kontratës operatorin ekonomik "ARFA GROUP" SH.P.K, Me datën 05.11.2019 ne kemi kërkuar qasje në dokumentet e këtij AP, qasja na është lejuar menjëherë. Me qasjen tonë në dokumente të operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës "ARFA GROUP" SH,P,K. ne kemi vërejtur se është devijuar shumë nga kriteret e përzgjedhjes të vendosura në Dosjen e Tenderit dhe shkelje të rënda të LPP-së. Dokumentet të cilat i mungojnë Operatorit Ekonomik "ARFA GROUP" SH.P.K janë: Deklarata për Specifikacione Teknike Sipas Nenit 28 Specifikacionet Teknike të ligjit NR. 04/L-042 i prokurimit publik i Republikës së Kosovës i plotësuar dhe i ndryshuar me ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, ligjin 05/L-092 i mungon Deklarata për

Specifikacione Teknike si dhe Aneksi i specifikacionet teknike të detyrueshme nuk janë të nënshkruar dhe të vulosur, Plani dinamik mbi kryerjen e punimeve Operatorit Ekonomik "ARFA GROUP" SH.P.K si fitues i tenderit është dashur t'i ketë këto dokumente si: Vërtetimi i Atk-së Certifikata e Gjykatës Ekonomike Vërtetimi i Tatimit në Pronë Tek kërkesat mbi mundësin teknike dhe/ose profesionale pika & 9.2. Kërkesa e Autoritetit Kontraktues ka qenë: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 20 (njëzet) punëtorë. Operatorit Ekonomik "ARFA GROUP" SH.P.K si fitues i tenderit nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme se ka punëtorë të mjaftueshëm për kryerjen e punimeve. Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur as listë të punëtorëve nga Atk-ja as Kontrata të punëtorëve etj. Pos kësaj Operatori i rekomanduar për dhënie të kontratës ka paraqitur dëshmi të rreme në lidhje me punëtorët dhe listën e punëtorëve të paraqitur në dosjen e tenderit, ai ka paraqitur si punëtorë në listën e tij: Bekë Gaxherri me nr personal: 1173682987 si punëtorë të kompanisë "ARFA GROUP" SH.P.K ky person është nga Komuna e Junikut dhe ka migruar në Gjermani që nga viti 2018. Shqiprim Ramosaj me nr personal: 1173537162 si punëtorë të kompanisë "ARFA GROUP" SH.P.K, ky person është nga Komuna e Decanit dhe që nga muaji Mars është pjesë e kompanisë Joos& Krasniqi-Bazë "Sh.p.k një të tillë mund ta vërtetoni nga Administrata Tatimore e Kosovës. Këtë mund ta gjeni edhe tek lista e punëtorëve të paraqitur nga kompania jonë . Tek lista e Stafit Profesional të paraqitur nga "ARFA GROUP" SH.P.K si fitues i tenderit nuk e ka të kompletuar siç duhet.

o Inxh,Mevlan Bixhaku i deklaruar si inxh i komunikacionit, mirëpo diploma e tij nuk ka të bëjë me Komunikacion, gjithashtu CV-ia e tij nuk është origjinal sig është kërkuar në dosjen e tenderit. o Inxh.Hidajete Hadergjona Inxhinier e Elektroteknikës, kontratën e paraqitur e ka të pa nënshkruar. Sigurimi i Tenderit i paraqitur nga Operatori Ekonomik "ARFA GROUP" SH.P.K si fitues i tenderit është i pa kompletuar. Të gjitha këto konstatime dhe prova të lartcekura vërtetojnë se AK në rastin konkret në mënyrë flagrante ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të lartcekura të Lpp-së. duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara sepse AK më dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë nuk ka kërkuar deklaratë mbi specifikacionin teknik, por në Aneksin 1 të dosjes së tenderit ka specifikuar se specifikacioni teknik është dhënë në paramasë, ndërsa OE "ARFA GROUP" SH.P.K e ka të nënshkruar dhe vulosur paramasen-ofertën financiare, andaj pretendimi i OE ankuese nuk qëndron. Pretendimi i OE ankuese lidhur me Planin Dinamik eksperti shqyrtues konstaton se AK më dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë nuk ka kërkuar dorëzim të Planit Dinamik, por në piken 17.2 të KVK në dosjen e tenderit AK ka parashikuar 1095 ditë për përfundim të këtij projekti nga data e fillimit të punëve, andaj pretendimi i OE ankuese nuk qëndron. Pretendimi i OE ankuese lidhur me dokumentet: Vërtetimi i Atk-së, Certifikata e Gjykatës Ekonomike dhe Vërtetimi i Tatimit në Pronë eksperti shqyrtues konstaton se nga AK janë

kërkuar vetëm për fituesin e kontratës e në rastin konkret me raportin e fundit të vlerësimit AK nuk ka rekomanduar për kontratë OE "ARFA GROUP" SH.P.K, por grupin e OE-ve "N.SH.T. Victory Com & Murseli Sh.p.k", andaj pretendimi i OE ankuese nuk qëndron. Pretendimi i OE ankuese lidhur me dëshmitë e punëtorëve të OE "ARFA GROUP" SH.P.K respektivisht rreth listës së punëtorëve nga ATK dhe kontratat e punëtorëve, eksperti shqyrtues konstaton se nga AK nuk është kërkuar që lista e punëtorëve të jetë nga ATK si dhe që për punëtorët të dorëzohen kontratat por AK ka kërkuar: Kërkesa: 2. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 20 (njëzetë) punëtorë të mjaftueshëm për kryerjen e projektit dhe a.) një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv me tri vite përvojë pune pas diplomimit b.) një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë – drejtimi hidroteknik me tri vite përvojë pune pas diplomimit c.) Një inxhinier i diplomuar i komunikacionit ose master i inxhinierisë mekanike – drejtimi komunikacion (transport) me minimum pesë vite përvojë pune pas diplomimit d.) një inxhinier i diplomuar i elektroteknikës me tri vite përvojë pune pas diplomimit e.) një gjeodet ose teknik i gjeodezisë (gjeometër) me tri vite përvojë pune pas diplomimit Dëshmia: 2. Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj udhëheqës dhe fuqisë tjetër punëtorë, CV-a (origjinal e nënshkruar nga inxhinieri), Diploma, Kontrata e punës me ofertuesin (origjinal, në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë).

ndërsa OE "ARFA GROUP" SH.P.K ka dorëzuar listën e punëtorëve me të dhënat e 34 punëtorëve, listën e personelit teknik prej 5 inxhinjerave për të cilët ka bashkangjitur kopjet e diplomave të noterizuara, kontratat e punës, cv dhe referencat, andaj pretendimi i OE ankuese nuk qëndron. Pretendimi i OE ankuese lidhur me punëtorët të cilët janë prezantuar në listën e punëtorëve të OE "ARFA GROUP" SH.P.K : Bekë Gaxherri është nga Komuna e Junikut dhe ka migruar në Gjermani që nga viti 2018, eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi rreth punëtorit në fjalë është cekur vetëm sipërfaqësisht nga OE ankuese pa ofruar ndonjë dëshmi konkrete, ndërsa lidhur me pretendimin rreth punëtorit Shqiprim Ramosaj se i njëjti është nga Komuna e Deçanit dhe që nga muaji Mars është pjesë e kompanisë Joos& Krasniqi-Bazë "Sh.p.k një të tillë mund ta vërtetoni nga Administrata Tatimore e Kosovës, eksperti shqyrtues konstaton se i njëjti punëtor ekziston në listën e punëtorëve të OE "ARFA GROUP" SH.P.K si dhe në listën e punëtorëve të Atk-së të OE "Joos& Krasniqi-Bazë "Sh.p.k , duke pasqyruar se në listën e punëtorëve të OE "ARFA GROUP" SH.P.K janë paraqitur 34 punëtor ndërsa nga AK janë kërkuar që OE të dëshmojnë se kanë 20 punëtor, pretendimet OE ankuese rreth punëtorëve të lartë cekur nuk do të kishin ndikim në numrin e punëtorëve të kërkuar nga AK, andaj duke pasqyruar gjitha faktet e cekura më lartë eksperti shqyrtues mendon se pretendimet në fjalë janë pjesërisht të qëndrueshme. Pretendimi i OE ankuese lidhur me Inxh,Mevlan Bixhaku i deklaruar si inxh i komunikacionit, mirëpo diploma e tij nuk ka të bëjë me Komunikacion, gjithashtu CV-ia e tij nuk është origjinal siq është kërkuar në dosjen e

tenderit Eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi rreth inxh te komunikacionit është trajtuar dhe vendosur me Vendimin e PSH nr.448/19 dt.24.09.2019, ndërsa lidhur me pretendimin rreth Inxh.Hidajete Hadergjonaj Inxhinier e Elektroteknikës, se kontratën e paraqitur e ka të pa nënshkruar, eksperti shqyrtues konstaton se kontrata në fjalë është e nënshkruar nga inxh.Hidajete Hadergjonaj ka vulën e OE "ARFA GROUP" SH.P.K por nuk ka nënshkrim të përfaqësuesit të OE "ARFA GROUP" SH.P.K, andaj eksperti shqyrtues mendon se pretendimet në fjalë janë pjesërisht të qëndrueshme. Pretendimi i OE ankuese lidhur me Sigurimi i Tenderit i paraqitur nga Operatori Ekonomik "ARFA GROUP" SH.P.K si fitues i tenderit është i pa kompletuar, eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim i OE ankuese është cekur vetëm sipërfaqësisht pa sqaruar se çka ka nënkuptuar me “i pa kompletuar” ndërsa OE "ARFA GROUP" SH.P.K ka dorëzuar polisen e sigurimit të lëshuar nga “ K SIGKOS” me numër 060030090064194 e cila përmban vlerën e sigurisë dhe kohëzgjatjen konform kërkesës së parashtruar nga AK me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, andaj pretendimi i OE ankuese nuk qëndron.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 7, par. 2 i nenit 24, neni 56, par. 1, 2 dhe 4 i nenit 59, neni 60 dhe par. 6 i nenit 108/A të LPP-së, me arsyetimin se: “Me qasjen tonë kemi vërtetuar se edhe këta Operator Ekonomik janë të pa përgjegjshëm në bazë të dispozitave të LPP-së.

Dokumente të cilat i mungojnë operatorit ekonomik Asfaliti Sh.p.k janë: Deklarata NënBetim nuk e ka datën e hapjes së tenderit. Sepecifikacionet teknike të dosjes së tenderit nuk janë të vulosura. Plani Dinamik mbi realizimin e projektit, Operatori ekonomik Asfalti Sh.pk nuk ka arritur të dëshmoj se mund të angazhoj staf të mjaftueshëm profesional dhe të punëtorëve për kryerjen e punimeve. Ai ka prezantuar vetëm 16 punëtorë me kontrata dhe jo 20 punëtorë siç është kërkuar në dosjen e tenderit. Tek lista e stafit profesional të paraqitur nga operatori ekonomik Asfaliti Sh.p.k ka mangësi si: Këtij operatori ekonomik i mungon një Inxhinier i Elektroteknikës Ismet Hulaj Inxhinier i Ndërtimtarisë , CV-ja e tij nuk është e nënshkruar dhe origjinale. Ismer Shala, Inxhinier i Gjeodezisë, Diplomën e paraqitur nuk e ka në tri gjuhët zyrtare Shqip, Anglisht ose Serbisht, diploma e tij është në gjuhën Kroate. Avdi Qitaku, Inxhinier i Hidroteknikës CV-ia e tij nuk është e nënshkruar dhe Original, Pajazit Shala, Inxhinier i Komunikacionit, Diplomën e paraqitur nuk e ka në tri gjuhët zyrtare Shqip, Anglisht ose Serbisht, diploma e tij është në gjuhën Kroate. Ky person në CV-in e tij ka deklaruar se punon në Autoritetin Kontraktues Komuna e Pejës. Si ka mundësi ky person të angazhohet në projektin në fjalë? Operatorit ekonomik Asfaliti Sh.p.k i mungojnë edhe dy kamionë me konstrukcion ndërtimi Riper mbi 10t. Kamioni me targa 03-890-ÀK i paraqitur nga kompania Asfaliti Sh.p.k është kamion kokë tërheqës të cilit i mungon Rimorkio. Kamioni me targa 03-258-BF i paraqitur nga kompania Asfaliti Sh.p.k është kamion kokë tërheqës të cilit i mungon Rimorkio.”

Duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se

pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara sepse AK më dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë nuk ka kërkuar që deklarata nën betim të ketë datën e hapjes dhe deklaratë mbi specifikacionin teknik, por në Aneksin 1 të dosjes së tenderit ka specifikuar se specifikacioni teknik është dhënë në paramasë, ndërsa OE "Asfaliti Sh.p.k" e ka dorëzuar deklaratën nën betim të vulosur, të nënshkruar me datë 05.06.2019 si dhe paramasën-ofertën financiare, andaj pretendimi i OE ankuese nuk qëndron. Pretendimi i OE ankuese lidhur me Planin Dinamik ekspertit shqyrtues konstaton se AK më dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë nuk ka kërkuar dorëzim të Planit Dinamik, por në piken 17.2 të KVK në dosjen e tenderit AK ka parashikuar 1095 ditë për përfundim të këtij projekti nga data e fillimit të punëve, andaj pretendimi i OE ankuese nuk qëndron. Pretendimi i OE ankuese lidhur me dëshmitë e punëtorëve të OE "Asfaliti Sh.p.k" respektivisht rreth kontratave të punëtorëve kontratat e punëtorëve dhe staf të mjaftueshëm profesional, ekspertit shqyrtues konstaton se nga AK nuk është kërkuar që për punëtorët të dorëzohen kontratat por AK ka kërkuar: Kërkesa:

2. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 20 (njëzetë) punëtorë të mjaftueshëm për kryerjen e projektit dhe a.) një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv me tri vite përvojë pune pas diplomimit b.) një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë – drejtimi hidroteknik me tri vite përvojë pune pas diplomimit c.) Një inxhinier i diplomuar i komunikacionit ose master i inxhinierisë mekanike – drejtimi komunikacion (transport) me minimum pesë vite përvojë pune pas diplomimit d.) një inxhinier i diplomuar i elektroteknikës me tri vite përvojë pune pas diplomimit e.) një gjeodet ose teknik i gjeodezisë (gjeometër) me tri vite përvojë pune pas diplomimit Dëshmia: 3. Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj udhëheqës dhe fuqisë tjetër punëtorë, CV-a (origjinal e nënshkruar nga inxhinieri), Diploma, Kontrata e punës me ofertuesin (origjinal, në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë) ndërsa OE "Asfaliti Sh.p.k" ka dorëzuar listat e punëtorëve me të dhënat e mbi 30 punëtorëve për vitet 2016, 2017, 2018 dhe 2019, listën e personelit teknik prej 5 inxhinierëve për të cilët ka bashkangjitur kopjet e diplomave të noterizuara, kontratat e punës, cv dhe referencat, mirëpo ekspertit shqyrtues konstaton se: Qëndron pretendimi i OE ankuese se OE "Asfaliti Sh.p.k" i mungon një Inxhinier i Elektroteknikës Jo Ismet por- Ismail Hulaj Inxhinier i Ndërtimtarisë , CV-ja e tij nuk është e nënshkruar siq ka kërkuar AK me njoftim për kontratë dhe dosjen e tenderit.. Jo Ismet por- Ismet Shala, Inxhinier i Gjeodezisë, diploma e tij është në gjuhën Kroate të vitit 1980 por i njëjti posedon edhe certifikatën e provimit profesional të gjeodezisë të lëshuar në vitin 1989 në gjuhën shqipe. Avdi Qitaku, Inxhinier i Hidroteknikës CV-ja e tij nuk është e nënshkruar. Pajazit Shala, Inxhinier i Komunikacionit, Diplomën e paraqitur e ka në gjuhën Kroate të lëshuar në vitin 1996. Si dhe në CV-in e tij ka deklaruar se punon në Autoritetin Kontraktues Komuna e Pejës, andaj bazuar në faktet e lartcekura ekspertit shqyrtues mendon

se pretendimet e OE ankuese rreth stafit të "Asfaliti Sh.p.k" janë pjesërisht të qëndrueshme. Pretendimi i OE ankuese lidhur se OE "Asfaliti Sh.p.k" i mungojnë edhe dy kamionë me konstruksion ndërtimi kiper mbi 10t dhe se kamionët me targa: 03-890-ÀK dhe 03-258-BF të paraqitur nga kompania "Asfaliti Sh.p.k" janë kamion kokë tërëheqës të cilit i mungon Rimorkio eksperti shqyrtues konstaton se bazuar në kopjet e librezave të qarkullimit dy kamionët në fjalë janë kamion kokë tërëheqës me dy dyer mirëpo OE "Asfaliti Sh.p.k" të njetit në listë i ka të prezantuar për kamion me konstruksion kiper si dhe ka bashkangjitur kopjet e librezave dhe disa foto në të cilat shihet disa kamion të cilët janë me rimorkio dhe disa tjerë që janë kamion kokë tërëheqës andaj bazuar në faktet e lartecaktuara eksperti shqyrtues mendon se pretendimet e OE ankuese rreth stafit kamionëve janë pjesërisht të qëndrueshme.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 7, par .2 i nenit 24, neni 56, par. 1, 2 dhe 4 i nenit 59, neni 60 dhe par. 6 i nenit 108/A të LPP-së, me arsyetimin se:

"Me qasjen tonë kemi vërtetuar se edhe këta Operator Ekonomik janë të pa përgjegjshëm në bazë të dispozitave të LPP-së: Dokumente të cilat i mungojnë Koncerzimit "N.T.SH, Marash-Shped Sh.p.k & COMPANY "BEJTA COMMERCE"SH.A." janë: Plani Dinamik mbi realizimin e projektit, Certifikata e Biznesit e Kompanisë COMPANY "BEJTA COMMERCE"SH.A. është certifikatë e vjetër nuk është e ndryshuar nga ARBK-ja. Sigurimi i Tenderit i paraqitur nga ky Konzorcium nuk ka të bëjë me këtë Tender, ky konzorcium ka paraqitur një sigurim të tenderit tjetër. Konzorciumit në fjalë i mungon ISO PASS 99-2012. Marrëveshja e furnizimit me Asfalt e kompanisë COMPANY"BEJTA COMMERCE"SH.A. me kompaninë "Rahovica Commerce" Sh.p.k në Ferizaj, është marrëveshje e datës: 06.02.2019, si dhe nuk është marrëveshje e projektit në fjalë dhe nuk është në Origjinal. Marrëveshja e furnizimit me Beton e kompanisë COMPANY "BEJTA COMMERCE"SH.A. me kompaninë "Sistem" Sh.p.k, është marrëveshje e datës:06.02.2019, si dhe nuk është marrëveshje e projektit në fjalë. Makineritë që i mungojnë këtij konzorciumi i gjeni si më poshtë: 2 Kamion 1 Finisher Vlen të theksohet se shumica e makinerive të paraqitura nga konzorciumi nuk dallohen dhe nuk shihen mirë. Kontratat për 20 puntorë mungojnë Lista e stafit Profesional i paraqitur nga konzorciumi në fjalë nuk është në rregull dhe ka shumë mungesa si: Inxhinieri i Ndërtimtarisë Muhamet Selimi CV-në nuk e ka në Origjinal sig është kërkuar në Dosjen e Tenderit. Inxhinieri i Hidroteknikë Skender Ramadani kontrata e punës e paraqitur e tij ka skaduar si dhe CV-n nuk e ka në origjinal. Zija Mezi Inxhinier i Ndërtimtarisë kontrata e punës e paraqitur e tij ka skaduar. Zijadin Kastrati inxhinier i paraqitur i Komunikacionit CV-ia e tij nuk është origjinal dhe nuk është e nënshkruar, si dhe ky person nuk ka kontratë të punës. Kristë Duzhmani Inxhinier i Elektroteknikës, CV-ija e tij nuk është origjinal dhe nuk është e nënshkruar, si dhe ky person nuk ka Kontratë të punës. duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti

shqyrtues konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara sepse : Pretendimi i OE ankuese lidhur me Planin Dinamik ekspertit shqyrtues konstaton se AK më dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë nuk ka kërkuar dorëzim të Planit Dinamik, por në piken 17.2 të KVK në dosjen e tenderit AK ka parashikuar 1095 ditë për përfundim të këtij projekti nga data e fillimit të punëve, andaj pretendimi i OE ankuese nuk qëndron.

Pretendimi i OE ankuese lidhur Certifikata e Biznesit e Kompanisë "BEJTA COMMERCE"SH.A. është certifikatë e vjetër nuk është e ndryshuar nga ARBK-ja, ekspertit shqyrtues konstaton se nga AK nuk ka qenë kërkesë që certifikatat e biznesit të kompanive të jenë të ndryshuara nga ARBK-ja, andaj pretendimi i OE ankuese nuk qëndron.

Pretendimi i OE ankuese se Konzorciumi "N.T.SH. Marash - Shped Sh.p.k & COMPANY "BEJTA COMMERCE"SH.A. nuk ka të bëjë me këtë Tender, ky konzorcium ka paraqitur një sigurim të tenderit tjetër. ekspertit shqyrtues konstaton se konzorciumi në fjalë ka bashkangjitur sigurinë e tenderit të lëshuar nga " K SIGKOS" e cila përmban titullin "Ndërtimi i rrugës me asfalt-Kontratë tri vjeçare", nr. e prokurimit të këtij aktiviteti, vlerën e sigurisë dhe kohëzgjatjen konform kërkesës së parashtruar nga AK me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, ku në këtë sigurim shihet në vendet të emrit "Radoniq" është përdorur fjalia "me asfalt" një devijim i vogël, andaj pretendimi i OE ankuese nuk qëndron.

Pretendimi i OE ankuese se Konzorciumi "N.T.SH.Marash-Shped Sh.p.k & COMPANY "BEJTA COMMERCE"SH.A. i mungon ISO PASS 99-2012, ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim qëndron sepse konzorciumi në fjalë nuk ka bashkangjitur dëshmi për ISO PASS 99-2012. Pretendimi i OE ankuese se Marrëveshja e furnizimit me Asfalt e kompanisë COMPANY"BEJTA COMMERCE"SH.A. me kompaninë "Rahovica Commerce"Sh.p.k në Ferizaj, është marrëveshje e datës: 06.02.2019, si dhe nuk është marrëveshje e projektit në fjalë dhe nuk është në Original si dhe marrëveshja e furnizimit me Beton me kompaninë "Sistem" Sh.p.k, është marrëveshje e datës:06.02.2019, si dhe nuk është marrëveshje e projektit në fjalë, ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim nuk qëndron sepse marrëveshjet në fjalë janë lidhur në mes kompanive me qëllim të përkrahjes së kompanisë "Bejta Commerce" sh.a në të gjitha projektet gjatë viti 2019 dhe si të tilla nuk mund të konsiderohen se nuk janë edhe për këtë aktivitet të prokurimit. Pretendimi i OE ankuese se Konzorciumi "N.T.SH.Marash-Shped Sh.p.k & COMPANY "BEJTA COMMERCE"SH.A i mungojnë makineria si: 2 Kamion dhe 1 Finisher, ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim qëndron sepse konzorciumi në fjale në listën e makinerive ka specifikuar se posedon 7 kamion dhe 2 finisher mirëpo dëshmitë i ka bashkangjitur vetëm për 4 kamion dhe 1 finisher, po ashtu vlen të theksohet se shumica e dëshmimeve mbi makinerinë të paraqitura nga konzorciumi nuk dallohen dhe nuk shihen mirë. Pretendimi i OE ankuese se Konzorciumi "N.T.SH.Marash-Shped Sh.p.k & COMPANY "BEJTA COMMERCE"SH.A i mungojnë kontratat për 20 punëtorë, ekspertit shqyrtues

konstaton se ky pretendim nuk qëndron sepse AK nuk ka kërkuar që për 20 punëtorët të paraqiten kontratat por vetëm listën e punëtorëve. Pretendimi i OE ankuese se Konzorciumit “N.T.SH.Marash-Shped Sh.p.k & COMPANY "BEJTA COMMERCE"SH.A ka shumë mungesa në Listën e stafit Profesional si: Inxhinieri i Ndërtimtarisë Muhamet Selimi CV-në nuk e ka në Origjinal siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit, eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim nuk qëndron sepse CV e inxhinierit në fjalë është e noterizuar.

Inxhinieri i Hidroteknikë Skender Ramadani kontrata e punës e paraqitur e tij ka skaduar si dhe CV-n nuk e ka në origjinal, eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim pjesërisht qëndron sepse CV e inxhinierit në fjalë është e nënshkruar ndërsa kontrata e punës i ka skaduar me datën 30.12.2019. Zija Mezi Inxhinier i Ndërtimtarisë kontrata e punës e paraqitur e tij ka skaduar, eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim qëndron sepse kontrata e punës e këtij inxhinieri i ka skaduar. Zijadin Kastrati inxhinier i paraqitur i Komunikacionit CV-ia e tij nuk është origjinal dhe nuk është e nënshkruar, si dhe ky person nuk ka kontratë të punës, eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim pjesërisht qëndron sepse për të njëjtin inxhinier ekziston kontrata me anëtarin e konzorciumit “N.T.SH.Marash-Shped Sh.p.k. Kristë Duzhmani Inxhinier i Elektroteknikës, CV-ija e tij nuk është origjinal dhe nuk është e nënshkruar, si dhe ky person nuk ka Kontratë të punës. eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim pjesërisht qëndron sepse për të njëjtin inxhinier ekziston kontrata me anëtarin e konzorciumit “N.T.SH.Marash-Shped Sh.p.k.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 7, par.2 i nenit 24, neni 56, par. 1, 2 dhe 4 i nenit 59, neni 60 dhe par. 6 i nenit 108/A të LPP-së, me arsyetimin se: “Dokumentet të cilat i mungojnë konzorciumit të rekomanduar për dhënie të kontratës N.SH.T. Victory Com & Murseli Sh.p.k janë: Vërtetimi nga Administrata Tatimore e Kosovës për të dy Operatorët Certifikata e Gjykatës Ekonomike për të dy Operatorët Vërtetimi i Tatimit në Pronë për të dy Operatorët Deklarate Specifikacioneve Teknike për të dy Operatorët Certifikatat e biznesit këto dy kompani i kane të vjetra, nuk i kane ti rejat të ndryshuara nga ARBK-ja. Këtij Konzorciumi i mungon ISO 9001-2015, ISO e paraqitur nga kompania N.SH.T. Victory Com është iso të cilës i ka skaduar Afati. N. SH.T. Victory Com si lider i konzorciumit nuk ka arritur të dëshmojë se ka punë të ngjashme referenca ose Pranime Teknike, 60% të vlerës 750,000.00 Euro në tri vitet e fundit që i bie 450,000.00€. Marrëveshja e asfaltit e paraqitur nga kompania N.SH.T. Victory Com me kompaninë Asfalt Grup është marrëveshja pa datë, pa emër të projektit dhe është marrëveshje vetë m për shfrytëzimin e Licencës, e jo për furnizim me asfalt për projektin në fjalë. Marrëveshja për Beton e Gurthyes e paraqitur nga kompania N.SH.T. Victory Com me kompaninë Benita Com është marrëveshja pa datë, pa emër të projektit dhe është marrëveshje vetë m për shfrytëzimin e Licencës, e jo për furnizim me Beton e Zhavor për projektin në fjalë. Konzorciumi i rekomanduar për dhënie të kontratës N.SH.T. Victory Com & Murseli Sh.p.k nuk kanë arritur të

dëshmojnë se kane staf mjaftueshëm të punëtorëve për kryerjen e punimeve në këtë projekt. Kompania N.SH.T.

Victory Com ka paraqitur një Listë prej 20 punëtorëve, kjo kompani njëherësh ka paraqitur edhe një Listë të punëtorëve për vitin 2018, Listë e Cila i përmban vetëm 10 punëtorë dhe të cilët në muajin nëntor e dhjetorë të viti 2018 nuk kanë qenë në punë, Këtyre punëtorëve gjithashtu ju mungojnë edhe kontratat e punës sig janë kërkuar në Dosjen e Tenderit. Lista e Stafit Profesional e këtij Konzorciumi është me shumë probleme: Uran Mulaj, Inxhinier i Komunikacionit nuk e ka CV-in origjinale të paraqitur as të nënshkruar. Jeton Shasivari, Inxhinier i Hidroteknikës është Inxhinier me I (një) vit përvojë pune, nuk ka eksperiencën përvojë pune Siq është kërkuar në dosjen e tenderit. CV-ia e këtij inxhinieri nuk është origjinal as e nënshkruar. Beqë Hadergjonaj, Inxhinier i Ndërtimtarisë i paraqitur nga kompania N.SH.T. Victory Com, kontratën e punës e ka vetëm për aplikime në tenderë e jo për angazhim në këtë projekt. CV-ia e tij nuk është origjinal as e nënshkruar sig kërkohej në FDT. Suad qmaga, CV-ja e tij nuk është origjinal as e nënshkruar, si dhe në kontratë të punës ky inxhinier është që nga viti 2017, ndërsa në listen e paraqitur nga ATK-ja ky person në muajin nëntor e dhjetorë nuk ka qenë i angazhuar . Inxhinieri i Elektroteknikës z Faton Pylla i paraqitur nga kompania N.SH.T, Victory Com kontratën e punës e ka me validitet të skaduar, po kjo kontratë është kontratë vetëm për pjesëmarrje në tenderë e jo për angazhimin në projektin në Oalë. Këtij inxhinieri i mungon edhe CV-ja. Marrveshja e paraqitur nga kompania N.SH.T. Victory Com me kompaninë Gurbardhi është marrëveshje pa datë, nuk e ka të specifikuar titullin e projektit si dhe specifikacionet mbi makineritë nuk janë të shënuara. Marrëveshja e paraqitur nga kompania N.SH.T. Victory Com me kompaninë Rruga ING është marrëveshje pa datë, nuk e ka të specifikuar titullin e projektit si dhe specifikacionet mbi makineritë nuk janë të shënuara. Marrëveshja e paraqitur nga kompania N.SH.T Victory Com me kompaninë Mineral L.L.C është marrëveshje pa datë, nuk e ka të specifikuar titullin e projektit si dhe specifikacionet mbi makineritë nuk janë të shënuara. Këto prova do i gjeni të bashkangjitura në ankesë. Të gjitha këto konstatime dhe prova të lartcekura vërtetojnë se AK në rastin konkret në mënyrë flagrante ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të lartcekura të Lpp-së.” duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk janë të bazuara sepse: Pretendimi i OE ankuese lidhur me dokumentet: Vërtetimi i Atk-së, Certifikata e Gjykatës Ekonomike dhe Vërtetimi i Tatimit në Pronë, eksperti shqyrtues konstaton se nga AK janë kërkuar vetëm për fituesin e kontratës e në rastin konkret grupin e OE-ve “N.SH.T. Victory Com & Murseli Sh.p.k” i ka dorëzuar në AK të gjitha dokumentet e lartcekura sipas kërkesës së AK dhe të njëjtat janë dëshmuar nga AK për ekspertin me e-mailin e datës 11.12.2019, andaj pretendimi i OE ankuese nuk qëndron.

Pretendimi i OE ankuese se konzorciumi Certifikata e Biznesit i ka dorëzuar si certifikata e vjetër nuk

është e ndryshuar nga ARBK-ja, eksperti shqyrtues konstaton se nga AK nuk ka qenë kërkesë që certifikatat e biznesit të kompanive të jenë të ndryshuara nga ARBK-ja, andaj pretendimi i OE ankuese nuk qëndron. Pretendimi i OE ankuese se konzorciumit ne fjale i mungon deklarata mbi specifikacionin teknik, eksperti shqyrtues konstaton se në Aneksin 1 të dosjes se tenderit AK ka specifikuar se specifikacioni teknik është dhënë në paramasë, ndërsa grupi OE të rekomanduara për kontratë, e ka dorëzuar, paramasen-ofertën financiare të nënshkruar dhe vulosur, andaj pretendimi i OE ankuese nuk qëndron. Pretendimi i OE ankuese se këtij Konzorciumi i mungon ISO 9001-2015, ISO e paraqitur nga kompania N.SH.T. Victory Com është iso të cilës i ka skaduar Afati, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i OE ankuese nuk qëndron sepse certifikata e ISO 9001-2015 e dorëzuar nga konzorciumi N.SH.T. Victory Com & Murseli Sh.p.k ka validitet deri me datën 18.05.2021. Pretendimi i OE ankuese se N. SH.T. Victory Com si lider i konzorciumit nuk ka arritur të dëshmojë se ka punë te ngjashme referenca ose Pranime Teknike, 60% të vlerës 750,000.00 Euro në tri vitet e fundit që i bie 450,000.00€, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i lartcekur është trajtuar dhe vendosur me Vendimin e PSH nr.448/19 dt.24.09.2019. Pretendimi i OE ankuese se Marrëveshja e asfaltit e paraqitur nga kompania N.SH.T. Victory Com me kompaninë Asfaltit Grup është marrëveshja pa datë, pa emër të projektit dhe është marrëveshje vetëm për shfrytëzimin e Licencës, e jo për furnizim me asfalt për projektin në fjalë si dhe Marrëveshja për Beton e Gurthyes e paraqitur nga kompania N.SH.T. Victory Com me kompaninë Benita Com është marrëveshja pa datë, pa emër të projektit dhe është marrëveshje vetëm për shfrytëzimin e Licencës, e jo për furnizim me Beton e Zhavor për projektin në fjalë, eksperti shqyrtues sqaron se marrëveshjet në fjalë janë lidhur në mes kompanive me qëllim të përkrahjes së kompanisë N.SH.T. Victory Com në të gjitha projektet dhe si të tilla nuk mund të konsiderohen se nuk janë edhe për këtë aktivitet të prokurimit, andaj pretendimi i OE ankuese nuk qëndron. Pretendimi i OE ankuese se konzorciumi i rekomanduar për dhënie të kontratës N.SH.T. Victory Com & Murseli Sh.p.k nuk kanë arritur të dëshmojnë se kane staf mjaftueshëm të punëtorëve për kryerjen e punimeve në këtë projekt. Kompania N.SH.T. Victory Com ka paraqitur një listë prej 20 punëtorëve, kjo kompani njëherësh ka paraqitur edhe një Listë të punëtorëve për vitin 2018, Listë e Cila i përmban vetëm 10 punëtorë dhe të cilët në muajin nëntor e dhjetorë të viti 2018 nuk kanë qenë në punë, Këtyre punëtorëve gjithashtu ju mungojnë edhe kontratat e punës siç janë kërkuar në Dosjen e Tenderit, eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim nuk qëndron sepse AK nuk ka kërkuar që për 20 punëtorët të paraqiten kontratat por vetëm listën e punëtorëve. Pretendimi i OE ankuese se Lista e Stafit Profesional e këtij Konzorciumi është me shumë probleme: Uran Mulaj, Inxhinier i Komunikacionit nuk e ka CV-in origjinale të paraqitur as të nënshkruar.

Jeton Shasivari, Inxhinier i hidroteknikës është Inxhinier me 1 (një) vit përvojë pune, nuk ka eksperience

përvojë pune Siç është kërkuar në dosjen e tenderit. CV-ia e këtij inxhinieri nuk është origjinal as e nënshkruar. Beqë Hadergjonaj, Inxhinier i Ndërtimtarisë i paraqitur nga kompania N.SH.T. Victory Com, kontratën e punës e ka vetëm për aplikime në tendera e jo për angazhim në këtë projekt. CV-ia e tij nuk është origjinal as e nënshkruar siç kërkohet në FDT. Suad Qmega, CV-ja e tij nuk është origjinal as e nënshkruar, si dhe në kontratë të punës ky inxhinier është që nga viti 2017, ndërsa në listën e paraqitur nga ATK-ja ky person në muajin nëntor e dhjetorë nuk ka qene i angazhuar . Inxhinieri i Elektroteknikës z.Faton Pylla i paraqitur nga kompania N.SH.T, Victory Com kontratën e punës e ka me validitet të skaduar, po kjo kontratë është kontratë vetëm për pjesëmarrje në tenderë e jo për angazhimin në projektin në fjalë. Këtij inxhinieri i mungon edhe CV-ja. eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet e OE ankuese nuk qëndron sepse AK me rastin e rivlerësimit të ofertave konform ka kërkuar sqarime nga konzorciumi në fjalë dhe ka pranuar CV-te stafit të nënshkruara të cilat i ka dëshmuar përmes e-mailit të datës 11.12.2019, po ashtu eksperti shqyrtues sqaron nuk qëndron pretendimi i OE ankuese se Jeton Shasivari, Inxhinier i hidroteknikës është Inxhinier me 1 (një) vit përvojë pune sepse bazuar në referencën e bashkangjitur nga KUR Gjakova dëshmohej se i njëjti është në marrëdhënie pune nga 01.08.1987, po ashtu kontrata për Inxhinieri e Elektroteknikës z.Faton Pylla ka qenë valide me rastin e dorëzimit të tenderit sepse hapja është bërë me datën 06.06.2019 ndërsa kontrata në fjale ka qenë valide deri me datën 28.06.2019. Pretendimi i OE ankuese se Marrëveshja e paraqitur nga kompania N.SH.T. Victory Com me kompaninë Gurbardhi është marrëveshje pa datë, nuk e ka të specifikuar titullin e projektit si dhe specifikacionet mbi makineritë nuk janë të shënuara, eksperti shqyrtues sqaron se në këtë marrëveshje janë cekur pajisjet dy ngarkues me peshë mbi 10t. Marrëveshja e paraqitur nga kompania N.SH.T. Victory Com me kompaninë Rruga ING është marrëveshje pa datë, nuk e ka të specifikuar titullin e projektit si dhe specifikacionet mbi makineritë nuk janë të shënuara, eksperti shqyrtues sqaron se në këtë marrëveshje janë cekur pajisjet dy finisher, cilindra dhe rule 3 cope, kompresor ajri 1 cope, pres asfalti 1 cope dhe papuqe për ngjeshje 1 cope. Marrëveshja e paraqitur nga kompania N.SH.T Victory Com me kompaninë Mineral L.L.C është marrëveshje pa datë, nuk e ka të specifikuar titullin e projektit si dhe specifikacionet mbi makineritë nuk janë të shënuara, eksperti shqyrtues sqaron se në këtë marrëveshje janë cekur pajisjet Garder, Finisher, bydhndra dhe rule ngjeshes, 3 eskavator me peshe totale minimum 4-13 t, si dhe 4 kamiona me konstruktion ndertimi kipper mbi 10t, andaj pretendimet e OE ankuese nuk qëndrojnë sepse në marrëveshje e lartë cekura janë specifikuar pajisjet si dhe të njëjtat janë nënshkruar dhe vulosur nga kompanitë në fjale me qëllim të shfrytëzimit të pajisjeve në implemetnimit e projekteve sipas nevojave të N.SH.T Victory Com. Lidhur me pretendimi e OE ankuese se AK ka bërë shkelje të nenit 60 të LPP-së, eksperti Shqyrtues konstaton se ky pretendim nuk qëndron sepse konzorciumi i rekomanduar nga AK për dhënie të kontrates “N.SH.T. Victory Com & Murseli Sh.p.k” përmban vlerë financiare prej 308,074.75 € dhe është me e lirë në vlerë prej 71,823.75 € se sa ofertat e OE ankuese.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 28, 52, 69 dhe par.1 dhe 2 të nenit 80 të LPP-së duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës, ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk janë të bazuara sepse OE ankuese pretendimet në fjale vetëm i ka çekur sipërfaqësisht pa sqaruar dhe pa dhënë ndonjë fakt rreth shkeljes së këtyre neneve në deklaratën e ankesës se dorëzuar po ashtu me nenet 28, 52, 69 dhe par.1 dhe 2 të nenit 80 të LPP-së rregullohen respektivisht udhëzohen autoritetet kontraktuese se si duhet të vendosen në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë specifikacionin teknik, njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës, kërkesat minimale dhe dëshmitë që duhet të dorëzohen lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale, si dhe si duhet të formohet juria dhe si duhet të merren vendimet nga juria, gjatë ushtrimit/zhvillimit të një aktiviteti të prokurimit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertit shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, si dhe bazuar në pretendimet e OE ankuese, shkeljet e hasura në këtë procedurë nuk do të ndikojnë në rezultatin përfundimtar, andaj rekomandon që të mbetet në fuqi njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 12.12.2019 , me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 12.12.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 18.12.2019, ku kanë qenë prezent të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesi i OE-së ankues, ndërsa përfaqësuesit e AK-së nuk janë prezent në seancë, të njëjtit janë njoftuar në mënyrë të rregullt për mbajtjen e kësaj seance, të njëjtit nuk kanë njoftuar me arsyen e mos prezencës se tyre në këtë seancë, në seancë prezent është ekspertit shqyrtues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së s z. Krasniqi deklaroj: Ne në këtë projekt kemi ofertuar vetëm si “Joos&Krasniqi-Bazë” Sh.p.k me datë 04 Nëntor 2019 jemi njoftuar nga AK Komuna e Gjakovës se ne si OE jemi të pasuksesshëm.

AK Komuna e Gjakovës ka rekomanduar për dhënien e kontratës OE “ARFA GROUP” Sh.p.k.

Me pranimin e këtij e-mail ne kemi kërkuar qasje në dokumentet e OE “ARFA GROUP” Sh.p.k. me qasjen tonë kemi parë se ky operatorë ekonomik kemi vërejtur se është devijuar shumë nga kriteret e përzgjedhjes të vendosura në dosjen e tenderit.

OE “ARFA GROUP” Sh.p.k. i mungojnë dokumentet si:

- Deklarata për specifikacionet teknike
- Plani dinamik mbi kryerjen e punimeve
- Vërtetimi i ATK-së
- Certifikata e Gjykatës Ekonomike
- Vërtetimi i tatimit në pronë

OE “ARFA GROUP” Sh.p.k. si operator i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka arritur të dëshmojë se ka punëtorë të mjaftueshëm për kryerjen e punimeve. Ky operatorë ekonomik nuk ka paraqitur as listë të punëtorëve nga ATK-ja as kontratat e punës për punëtorë siç është kërkuar në dosjen e tenderit.

Pos kësaj OE i rekomanduar për dhënien e kontratës ka paraqitur dëshmi të rreme në lidhje me listën e punëtorëve të paraqitur në dosjen e tenderit. Si:

- Shqipërim Ramosaj me numër personal 1173537162, me vendbanim në Decan, i paraqitur si punëtorë i kompanisë “ARFA GROUP” Sh.p.k. ju bëjmë me dije që ky person që nga muaji mars është pjesë e kompanisë “Joos&Krasniqi-Bazë” Sh.p.k. një gjë të tillë mund ta verifikoni edhe nga ATK-ja.

Tek lista e stafit Professional të këtij operatori po ashtu ka shumë mangësi.

- Inxh. Mevlan Bixhaku i deklaruar si inxh. I komunikacionit, diploma e tij e paraqitur nuk ka të bëjë me komunikacion, CV-ja tij nuk është origjinal siç është kërkuar në dosjen e tenderit.

- Inxh. Hidajete Hadërgjonaj, inxh e elektroteknikës kontratën e paraqitur e ka të panënshkruar.

Sigurimi i tenderit i paraqitur nga OE ARFA GROUP Sh.p.k, është i pakompletuar.

Në qasjen tonë në dokumente ne kemi kërkuar qasje edhe në operatorët ekonomik të shpallur të përgjegjshëm nga AK Komuna e Gjakovës, kompanitë si: Asfalti Shpk, konzorciumi N.T.SH. Marash-Shped Sh.p.k & COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A.

Në qasjen tonë kemi konstatuar se edhe këta operatorë nuk janë të përgjegjshëm.

Dokumentet të cilat i mungojnë kompanisë Asfalti Sh.p.k janë:

- Deklarata nën betim, nuk e ka datën e hapjes së tenderit
- Specifikacionet teknike nuk janë të vulosura
- Plani dinamik mbi realizimin e projektit

OE Asfalti, nuk ka arritur të dëshmojë se mund të angazhojë staf të mjaftueshëm Professional dhe të punëtorëve për kryerjen e punimeve.

Ai ka prezantuar vetëm 16 punëtorë dhe jo 20 punëtorë siç është kërkuar.

OE Asfaltit I mungon një inxh. I elektroteknikës.

Ismet Hulaj, inxh. i ndërtimtarisë, CV-në nuk e ka në formën origjinale dhe as të nënshkruar.

Ismet Shala, inxh. I xheodezise, diplomën e ka në gjuhën kroate, nuk e ka në tri gjuhët zyrtare siç kërkohej në dosjen e tenderit.

Avdi Citaku, inxh. i hidroteknikës, CV-ia e tij nuk është e nënshkruar në origjinale siç është kërkuar në FDT.

Pajazit Shala, inxh. i komunikacionit, diplomën e ka në gjuhën kroate, në CV-në e tij ai ka deklaruar se punon në AK Komuna e Pejës. Si ka mundësi ky person të angazhohet në projektin në fjalë?

OE Asfalti i mungojnë edhe makineri si:

- Dy kamionë në konstruksion ndërtim kipper mbi 10 ton.
- Kamioni me traga 03-890-AK i paraqitur nga kompania Asfalti është kamion kokë tërheqëse të cilit i mungon rimorkio.
- Kamioni me traga 03-258-BF i paraqitur nga kompania Asfalti është kamion kokë tërheqëse të cilit i mungon rimorkio.

Dokumentet të cilat i mungojnë konzorciumit N.T.SH. Marash-Shped Sh.p.k & COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A. janë:

- Plani dinamik mbi realizimin e projektit
- Certifikata e Biznesit e kompanisë COMPANY “BEJTA COMMERCE” SH.A është certifikata e vjetër nuk është ndryshuar nga ARBK-ja.
- Sigurimi i tenderit i paraqitur nga ky konzorcium nuk ka të bëjë me këtë tender, ky konzorcium ka paraqitur një sigurim të denderit tjetër.
- Konzorciumi në fjalë i mungon ISO PASS 99-2012.
- Marrëveshja e furnizimit me asfalt e kompanisë COMPANY “BEJTA COMMERCE” SH.A me kompaninë “Rahovica Commerce” Sh.p.k në Ferizaj, është marrëveshje e datës: 06.02.2019, si dhe nuk është marrëveshje e projektit në fjalë dhe nuk është në origjinal.
- Marrëveshja e furnizimit me beton e kompanisë COMPANY “BEJTA COMMERCE” SH.A, si dhe nuk është marrëveshje e projektit në fjalë.
- Makineritë që i mungojnë këtij koncerizumit i gjeni si më poshtë:

2 kamionë

1 finisher

Vlen të theksohet që shumica e makinerive të paraqitura nga konzorciumi nuk shihen mirë.

Konzorciumi në fjalë nuk ka arritur të dëshmojë që i ka 20 punëtorë me kontrata.

Tek lista e stafit Professional edhe ky konzorcium ka mangësi si:

- Inxh. i ndërtimtarisë Muhamet Selimi CV-në nuk e ka në origjinal sic kërkohet në dosjen e tenderit
- Inxh. i hidrotëknikës Skender Ramadani kontrata e punës i ka skaduar si dhe CV-në nuk e ka në original.
- Inxh. e ndërtimtarisë Zija Mezi kontratën e paraqitur e ka të skaduar
- Inxh. i komunikacionit Zijadin Kastrati nuk ka kontratë të punës dhe CV-ia tij nuk është në formën origjinale.
- Inxh. i elektro teknikës Kristë Duzhmani nuk ka kontratë të punës si dhe CV-ia tij nuk është në formën origjinale.

Me datën 08.11.2019 kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim në AK Komuna e Gjakovës.

Me datën 12.11.2019 AK Komuna e Gjakovës e refuzon kërkesën për rishqyrtim të kompanisë N.SH.T VIKTORY COM si operatore ekonomik I papërgjegjshëm.

Me datën 14.11.2019 AK Komuna e Gjakovës e pranon kërkesën për rishqyrtim të kompanisë N.SH.T VIKTORY COM. Për ne si kompani është e papranueshme se si një autoritet kontraktues si Komuna e Gjakovës i ndërron vendimet brenda 48h.

Me datën 15.11.2019 Komuna e Gjakovës na njofton se ka pranuar kërkesën tonë për rishqyrtim.

Me datën 19.11.2019 Komuna e Gjakovës na njofton për vendimin e marrë në lidhje me rivlerësimin ku rekomandojnë për dhënie të kontratës konzorciumin N.SH.T VIKTORY COM & Murseli Sh.p.k.

Me marrjen e këtij vendimin ne si kompani kërkojmë qasje në dokumentet e këtij konzorciumi si dhe në raportin e vlerësimit. Me qasjen tonë kemi vërejtur se AK Komuna e Gjakovës shkel dispozitat e LPP-së si dhe ligjin e Prokurimit Publik.

Me rivlerësimin e bërë AK Komuna e Gjakovës, shkel nenin 108/A pika e 6 të cilët, nuk janë marrë me pretendimet tona të paraqitura në ankesë.

Me qasjen tonë, dokumentet të cilat i mungojnë konzorciumit të rekomanduar për dhënien e kontratës N.SH.T VIKTORY COM dhe MURSELISH.p.k janë:

- Vërtetimi i ATK-së për të dy operatorët
- Certifikata e gjykatës ekonomike për të dy operatorët
- Vërtetimi i tatimit në pronë për të dy operatorët
- Deklarata e specifikacioneve teknike për të dy operatorët
- Certifikatat e biznesit i kanë të vjetra, nuk i kanë të ndryshuara në ARBK

Këtij konzorciumi i mungon ISO 9001-2015, kjo ISO e paraqitur nga VIKTORY COM është ISO të cilës i ka skaduar afati.

N.SH. T VIKTORY COM si lider i konzorciumit nuk ka arritur të dëshmojë se ka punë të ngjashme, referenca ose pranime teknike, 60% të vlerës 750,000.00€ në tri vitet e fundit. Që I bie 450,000.00€

Marrëveshja e asfaltit e paraqitur nga kompania N.SH. T VIKTORY COM me kompaninë ASFALT GROUP është marrëveshje pa datë, pa emër të projektit dhe është marrëveshje vetëm për shfrytëzimin e licencës e jo për furnizim me asfalt për projektin në fjalë.

Marrëveshja për beton e gurëthyes e paraqitur nga kompania N.SH. T VIKTORY COM me kompaninë BENITA COM është marrëveshje pa datë, pa emër të projektit dhe është marrëveshje vetëm për shfrytëzimin e licencës e jo për furnizim me asfalt për projektin në fjalë.

Ky konzorcium nuk ka arrite të dëshmojë që ka as punëtorë për kryerjen e punimeve.

Kompania Victory ka paraqitur një listë prej 20 punëtorëve ndërsa në listën e ATK-së e vitit 2018 figurojnë vetëm 10 punëtorë.

Lista e stafit Professional e këtij konzorciumi nuk është e përgjegjshme sepse:

- Uran Mulaj, inxh. I komunikacionit, CV-në nuk e ka origjinal as të nënshkruar siç ceket në dosjen e tenderit.
- Jeton Shasivari, inxh. I hidroteknikës, është inxh me një vit përvojë pune, nuk e ka eksperiencën-përvojën e punës siç kërkohet ne dosjen e tenderit. Gjithashtu, CV-ia e tij nuk është origjinal dhe as e nënshkruar.
- Beqë Hadërgjonaj, inxh. I ndërtimtarisë I paraqitur nga VIKTORY kontratën e punës e ka vetëm për aplikim në tender dhe jo për angazhim në këtë projekt. Gjithashtu, CV-ia e tij nuk është origjinal dhe as e nënshkruar.
- Faton Pylla, inxh. I elektroteknikës kontratën e punës nuk e ka valide e ka të skaduar, gjithashtu kjo kontratë është vetëm për pjesëmarrje për tender dhe jo për angazhim në të. Këtij inxh. I mungon edhe CV-ia.

Marrëveshja e paraqitur e kompanisë NTSH Victory Com me kompaninë Gurëbardhi është marrëveshje pa datë, nuk e ka të specifikuar titullin e projektit si dhe specifikacionet e makinerive nuk janë shënuar.

Marrëveshja e paraqitur e kompanisë NTSH Victory Com me kompaninë Rruga ing është marrëveshje pa datë, nuk e ka të specifikuar titullin e projektit si dhe specifikacionet e makinerive nuk janë shënuar.

Marrëveshja e paraqitur e kompanisë NTSH Victory Com me kompaninë Mineral L,L.C është marrëveshje pa datë, nuk e ka të specifikuar titullin e projektit si dhe specifikacionet e makinerive nuk janë shënuar.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Krasniqi deklaroj: Qëndroj mbrapa raportit të dhënë në ekspertizë të datës 12.12.2019.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z.Krasniqi deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues të aprovon ankesën tone si të bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se OE ankues ka parashtruar ankesë kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues "Joos&Krasniqi-Bazë" Sh.p.k-Junik se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 7, par. 2 i nenit 24, neni 56, par. 1, 2 dhe 4 i nenit 59, neni 60 dhe par. 6 i nenit 108/A të LPP-së, me arsyetimin se: "Me dt: 04.11 2019 jemi njoftuar nga AK Komuna e Gjakovës se ne si operator ekonomik jemi të pa suksesshëm. Autoriteti kontraktues ka rekomanduar për dhënie të kontratës operatorin ekonomik "ARFA GROUP" SH.P.K, me datën 05.11.2019 ne kemi kërkuar qasje në dokumentet e këtij aktiviteti të prokurimit, qasja na është lejuar menjëherë. Me qasjen tonë në dokumente të operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës "ARFA GROUP" SH.P.K. ne kemi vërejtur se është devijuar shumë nga kriteret e përzgjedhjes të vendosura në Dosjen e Tenderit dhe shkelje të rënda të LPP-së. Dokumentet të cilat i mungojnë Operatorit Ekonomik "ARFA GROUP" SH.P.K janë:

- Deklarata për Specifikacione Teknike sipas nenit 28 Specifikacionet Teknike të ligjit për prokurim publik, i mungon aneksi i specifikacioneve teknike të detyrueshme, nuk janë të nënshkruar dhe të vulosur,
- Plani dinamik mbi kryerjen e punimeve të Operatorit Ekonomik "ARFA GROUP" SH.P.K,
- Si fitues i tenderit është dashur t'i ketë këto dokumente si: Vërtetimi i Atk-së Certifikata e Gjykatës Ekonomike, Vërtetimi i Tatimit në Pronë,
- Tek kërkesat mbi mundësin teknike dhe/ose profesionale pika & 9.2. Kërkesa e Autoritetit Kontraktues ka qenë: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 20 (njëzet) punëtorë. Operatorit ekonomik "ARFA GROUP" SH.P.K si fitues i tenderit nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme se ka punëtorë të mjaftueshëm për kryerjen e punimeve. Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur as listë të punëtorëve nga Atk-ja as Kontrata të punëtorëve etj.
- Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës ka paraqitur dëshmi të rreme në lidhje me punëtorët dhe listën e punëtorëve të paraqitur në dosjen e tenderit, ai ka paraqitur si punëtorë në listën e tij: Bekë Gaxherri me nr personal: 1173682987 si punëtorë të kompanisë "ARFA

GROUP" SH.P.K, ky person është nga Komuna e Junikut dhe ka migruar në Gjermani që nga viti 2018. Shqiprim Ramosaj me nr personal: 1173537162 si punëtorë të kompanisë "ARFA GROUP" SH.P.K, ky person është nga Komuna e Decanit dhe që nga muaji Mars është pjesë e kompanisë Joos& Krasniqi-Bazë "Sh.p.k një të tillë mund ta vërtetoni nga Administrata Tatimore e Kosovës. Këtë mund ta gjeni edhe tek lista e punëtorëve të paraqitur nga kompania jonë.

- Tek lista e Stafit Profesional të paraqitur nga "ARFA GROUP" SH.P.K si fitues i tenderit nuk e ka të kompletuar siç duhet. Inxh. Mevlan Bixhaku i deklaruar si inxh. i komunikacionit, mirëpo diploma e tij nuk ka të bëjë me Komunikacion, gjithashtu CV-ia e tij nuk është origjinal siç është kërkuar në dosjen e tenderit. Inxh. Hidajete Hadërgjonaj Inxhinier i Elektroteknikës, kontratën e paraqitur e ka të pa nënshkruar.
- Sigurimi i Tenderit i paraqitur nga Operatori Ekonomik "ARFA GROUP" SH.P.K si fitues i tenderit është i pa kompletuar.

Të gjitha këto konstatime dhe prova të lartcekura vërtetojnë se AK në rastin konkret në mënyrë flagrante ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të lartcekura të LPP-së.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Joos&Krasniqi-Bazë" Sh.p.k-Junik se OE të rekomanduar për kontratë i mungon aneksi i specifikacioneve teknike të detyrueshme, nuk janë të nënshkruar dhe të vulosur, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se AK në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë nuk ka kërkuar deklaratë mbi specifikacionin teknik, por në Aneksin 1 të dosjes së tenderit ka specifikuar se specifikacioni teknik është dhënë në paramasë, ndërsa OE "ARFA GROUP" SH.P.K e ka të nënshkruar dhe vulosur para masën-ofertën financiare. Andaj, ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Joos&Krasniqi-Bazë" Sh.p.k-Junik se OE të rekomanduar i mungon plani dinamik mbi kryerjen e punimeve të Operatorit Ekonomik "ARFA GROUP" SH.P.K, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se AK në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë nuk ka kërkuar dorëzim të Planit Dinamik, por në piken 17.2 të KVK në dosjen e tenderit AK ka parashikuar 1095 ditë për përfundim të këtij projekti nga data e fillimit të punëve, andaj pretendimi i OE ankuese është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Joos&Krasniqi-Bazë" Sh.p.k-Junik se OE të rekomanduar për kontratë është dashur t'i ketë këto dokumente si: Vërtetimi i Atk-së Certifikata e Gjykatës Ekonomike, Vërtetimi i Tatimit në Pronë. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron AK ka

kërkuar vetëm për fituesin e kontratës e në rastin konkret me raportin e fundit të vlerësimit AK nuk ka rekomanduar për kontratë OE "ARFA GROUP" SH.P.K, por grupin e OE-ve "N.SH.T. Victory Com & Murseli Sh.p.k". Andaj, ku pretendim është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Joos&Krasniqi-Bazë" Sh.p.k-Junik se OE të rekomanduar për kontratë nuk ka numër të mjaftueshëm të punëtorëve, konkretisht tek kërkesat mbi mundësin teknike dhe/ose profesionale pika & 9.2. Kërkesa e Autoritetit Kontraktues ka qenë: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 20 (njëzet) punëtorë. Operatorit ekonomik "ARFA GROUP" SH.P.K si fitues i tenderit nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme se ka punëtorë të mjaftueshëm për kryerjen e punimeve. Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur as listë të punëtorëve nga Atk-ja as Kontrata të punëtorëve, etj. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se AK nuk ka kërkuar që lista e punëtorëve të jetë nga ATK si dhe që për punëtorët të dorëzohen kontratat por AK ka kërkuar: Kërkesa: 2. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 20 (njëzetë) punëtorë të mjaftueshëm për kryerjen e projektit dhe a.) një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv me tri vite përvojë pune pas diplomimit b.) një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë – drejtimi hidroteknik me tri vite përvojë pune pas diplomimit c.) Një inxhinier i diplomuar i komunikacionit ose master i inxhinierisë mekanike – drejtimi komunikacion (transport) me minimum pesë vite përvojë pune pas diplomimit d.) një inxhinier i diplomuar i elektroteknikës me tri vite përvojë pune pas diplomimit e.) një gjeodet ose teknik i gjeodezisë (gjeometër) me tri vite përvojë pune pas diplomimit Dëshmia: 2. Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj udhëheqës dhe fuqisë tjetër punëtorë, CV-a (origjinal e nënshkruar nga inxhinieri), Diploma, Kontrata e punës me ofertuesin (origjinal, në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë). Ndërsa OE "ARFA GROUP" SH.P.K ka dorëzuar listën e punëtorëve me të dhënat e 34 punëtorëve, listën e personelit teknik prej 5 inxhinierëve për të cilët ka bashkangjitur kopjet e diplomave të noterizuara, kontratat e punës, cv dhe referencat. Andaj, pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Joos&Krasniqi-Bazë" Sh.p.k-Junik se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka paraqitur dëshmi të rreme në lidhje me punëtorët dhe listën e punëtorëve të paraqitur në dosjen e tenderit, ai ka paraqitur si punëtorë në listën e tij: Bekë Gaxherri me nr personal: 1173682987 si punëtorë të kompanisë "ARFA GROUP" SH.P.K, ky person është nga Komuna e Junikut dhe ka migruar në Gjermani që nga viti 2018. Shqiprim Ramosaj me nr personal: 1173537162 si punëtorë të kompanisë "ARFA GROUP" SH.P.K, ky person është nga Komuna e Decanit dhe që nga muaji Mars është pjesë e kompanisë Joos& Krasniqi-Bazë "Sh.p.k një gjë të tillë mund ta vërtetoni nga Administrata Tatimore e Kosovës. Këtë mund ta gjeni edhe tek lista e punëtorëve të paraqitur nga kompania jonë. Paneli Shqyrtues

sqaron se pretendimi rreth punëtorit Bekë Gaxherri është pjesërisht i bazuar për shkak se ky fakt nuk është vërtetuar nga eksperti profesional i prokurimit, kurse sa i përket punëtorit Shqiprim Ramosaj, Paneli Shqyrtues duke u bazuar në ekspertin profesional të prokurimit vlerëson se i njëjti punëtor ekziston në listën e punëtoreve të OE "ARFA GROUP" SH.P.K si dhe në listën e punëtoreve të Atk-së të OE "Joos&Krasniqi-Bazë" Sh.p.k. Andaj, ky pretendim ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Joos&Krasniqi-Bazë" Sh.p.k-Junik se OE i rekomanduar për kontratë, tek lista e Stafit Profesional të paraqitur nga "ARFA GROUP" SH.P.K si fitues i tenderit nuk e ka të kompletuar siç duhet. Inxh. Mevlan Bixhaku i deklaruar si inxh. i komunikacionit, mirëpo diploma e tij nuk ka të bëjë me Komunikacion, gjithashtu CV-ia e tij nuk është origjinal siç është kërkuar në dosjen e tenderit. Inxh. Hidajete Hadërgjonaj Inxhinier i Elektroteknikës, kontratën e paraqitur e ka të pa nënshkruar. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se pretendimi rreth inxh. të komunikacionit është trajtuar dhe vendosur me Vendimin e PSH.nr.448/19 dt.24.09.2019, ndërsa lidhur me pretendimin rreth Inxh. Hidajete Hadërgjonaj Inxhinier e Elektroteknikës, se kontratën e paraqitur e ka të pa nënshkruar, Paneli Shqyrtues sqaron se kontrata në fjalë është e nënshkruar nga inxh. Hidajete Hadërgjonaj dhe ka vulën e OE "ARFA GROUP" SH.P.K, por nuk ka nënshkrim të përfaqësuesit të OE "ARFA GROUP" SH.P.K. Ky pretendim ankimor është i bazuar sepse kontratat e punës duhet të jenë të nënshkruara edhe nga personi përgjegjës i OE.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Joos&Krasniqi-Bazë" Sh.p.k-Junik se OE i rekomanduar për kontratë se sigurimi i tenderit i paraqitur nga Operatori Ekonomik "ARFA GROUP" SH.P.K si fitues i tenderit është i pa kompletuar. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se ky pretendim i OE ankues është cekur vetëm sipërfaqësisht pa sqaruar se çka ka nënkuptuar me "i pa kompletuar". Për sqarim, OE "ARFA GROUP" SH.P.K ka dorëzuar polisën e sigurimit të lëshuar nga "K SIGKOS" me numër 060030090064194 e cila përmban vlerën e sigurisë dhe kohëzgjatjen konform kërkesës së parashtruar nga AK me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Joos&Krasniqi-Bazë" Sh.p.k-Junik kundër OE Asfaliti Sh.p.k. se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 7, par. 2 i nenit 24, neni 56, par. 1, 2 dhe 4 i nenit 59, neni 60 dhe par. 6 i nenit 108/A të LPP-së, me arsyetimin se: "Me qasjen tonë kemi vërtetuar se edhe këta Operator Ekonomik janë të pa përgjegjshëm në bazë të dispozitave të LPP-së. Më tej, OE ankues shton: Dokumente të cilat i mungojnë operatorit ekonomik Asfaliti Sh.p.k janë:

- Deklarata Nën Betim nuk e ka datën e hapjes së tenderit,
- Specifikacionet teknike të dosjes së tenderit nuk janë të vulosura,
- Plan Dinamik mbi realizimin e projektit,
- Operatori ekonomik Asfalti Sh.p.k nuk ka arritur të dëshmoj se mund të angazhoj staf të mjaftueshëm profesional dhe të punëtorëve për kryerjen e punimeve. Ai ka prezantuar vetëm 16 punëtorë me kontrata dhe jo 20 punëtorë siç është kërkuar në dosjen e tenderit.
- Tek lista e stafit profesional të paraqitur nga operatori ekonomik Asfalti Sh.p.k ka mangësi si: Këtij operatori ekonomik i mungon një Inxhinier i Elektroteknikës Ismet Hula Inxhinier i Ndërtimtarisë , CV-ja e tij nuk është e nënshkruar dhe origjinale. Ismer Shala, Inxhinier i Gjeodezisë, Diplomën e paraqitur nuk e ka në tri gjuhët zyrtare Shqip, Anglisht ose Serbisht, diploma e tij është në gjuhën Kroate. Avdi Qitaku, Inxhinier i Hidroteknikës CV-ja e tij nuk është e nënshkruar dhe Original, Pajazit Shala, Inxhinier i Komunikacionit, Diplomën e paraqitur nuk e ka në tri gjuhët zyrtare Shqip, Anglisht ose Serbisht, diploma e tij është në gjuhën Kroate. Ky person në CV-in e tij ka deklaruar se punon në Autoritetin Kontraktues Komuna e Pejës. Si ka mundësi ky person të angazhohet në projektin në fjalë?
- Operatorit ekonomik Asfalti Sh.p.k i mungojnë edhe dy kamionë me konstruksion ndërtimi Riper mbi 10t. Kamioni me targa 03-890-ÀK i paraqitur nga kompania Asfalti Sh.p.k është kamion kokë tërheqës të cilit i mungon Rimorkio. Kamioni me targa 03-258-BF i paraqitur nga kompania Asfalti Sh.p.k është kamion kokë tërheqës të cilit i mungon Rimorkio.”

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Joos&Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik duke pretenduar se OE Asfalti Sh.p.k. është i pa përgjegjshëm sepse i mungon deklarata Nën Betim, nuk e ka datën e hapjes së tenderit dhe Specifikacionet teknike të dosjes së tenderit nuk janë të vulosura. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se AK në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë nuk ka kërkuar që deklarata nën betim të ketë datën e hapjes dhe deklaratë mbi specifikacionin teknik, por në Aneksin 1 të dosjes se tenderit ka specifikuar se specifikacioni teknik është dhënë në paramasë, ndërsa OE " Asfalti Sh.p.k e ka dorëzuar deklaratën nën betim të vulosur, të nënshkruar me datë 05.06.2019 si dhe paramasën-ofertën financiare. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Joos&Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik duke pretenduar se OE Asfalti Sh.p.k. është i pa përgjegjshëm sepse i mungon plani dinamik mbi realizimin e projektit, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se AK në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë nuk ka kërkuar dorëzim të Planit Dinamik, por në piken 17.2 të KVK në dosjen e tenderit AK ka

parashikuar 1095 ditë për përfundim të këtij projekti nga data e fillimit të punëve. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Joos&Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik duke pretenduar se OE Asfaliti Sh.p.k. është i pa përgjegjshëm sepse operatori ekonomik Asfalti Sh.pk nuk ka arritur të dëshmoj se mund të angazhoj staf të mjaftueshëm profesional dhe të punëtorëve për kryerjen e punimeve. Ai ka prezantuar vetëm 16 punëtorë me kontrata dhe jo 20 punëtorë siç është kërkuar në dosjen e tenderit. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se OE “Asfaliti Sh.p.k” i mungon një Inxhinier i Elektroteknikës, Jo Ismet por- Ismail Hulaj Inxhinier i Ndërtimtarisë , CV-ja e tij nuk është e nënshkruar siç ka kërkuar AK me njoftim për kontratë dhe dosjen e tenderit.. Jo Ismer por- Ismet Shala, Inxhinier i Gjeodezisë, diploma e tij është në gjuhën kroate të vitit 1980 por i njëjti posedon edhe certifikatën e provimit profesional të gjeodezisë të lëshuar në vitin 1989 në gjuhën shqipe. Avdi Qitaku, Inxhinier i Hidroteknikës CV-ia e tij nuk është e nënshkruar. Pajazit Shala, Inxhinier i Komunikacionit, Diplomën e paraqitur e ka në gjuhën Kroate të lëshuar në vitin 1996. Si dhe në CV-in e tij ka deklaruar se punon në Autoritetin Kontraktues Komuna e Pejës. Andaj ky pretendim ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues “Joos&Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik se OE “Asfaliti Sh.p.k” i mungojnë edhe dy kamionë me konstruksion ndërtimi kiper mbi 10t dhe se kamionët me targa: 03-890-ÀK dhe 03-258-BF të paraqitur nga kompania “Asfaliti Sh.p.k” janë kamion kokë tërëheqës të cilët i mungon Rimorkio. Paneli Shqyrtues duke u bazuar në kopjet e librezave të qarkullimit, dy kamionët në fjalë janë kamion kokë tërëheqës me dy dyer mirëpo OE “Asfaliti Sh.p.k” të njëjtit në liste i ka të prezantuar për kamion me konstruksion kiper si dhe ka bashkangjitur kopjet e librezave dhe disa foto në të cilat shihen disa kamion të cilët janë me rimorkio dhe disa tjerë që janë kamion kokë tërëheqës. Andaj, ky pretendim ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Joos&Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 7, par .2 i nenit 24, neni 56, par. 1, 2 dhe 4 i nenit 59, neni 60 dhe par. 6 i nenit 108/A të LPP-së, me arsyetimin se: Me qasjen tonë kemi vërtetuar se edhe këta Operator Ekonomik janë të pa përgjegjshëm në bazë të dispozitave të LPP-së: Dokumente të cilat i mungojnë konzorciumit “N.T.SH, Marash-Shped Sh.p.k & COMPANY "BEJTA COMMERCE"SH.A.” janë:

- Plani Dinamik mbi realizimin e projektit,
- Certifikata e Biznesit e Kompanisë COMPANY "BEJTA COMMERCE"SH.A. është certifikatë e

vjetër nuk është e ndryshuar nga ARBK-ja,

- Sigurimi i Tenderit i paraqitur nga ky Konzorcium nuk ka të bëjë me këtë Tender,
- Ky konzorcium ka paraqitur një sigurim të tenderit tjetër,
- Konzorciumit në fjalë i mungon ISO PASS 99-2012,
- Marrëveshja e furnizimit me Asfalt e kompanisë COMPANY "BEJTA COMMERCE" SH.A. me kompaninë "Rahovica Commerce" Sh.p.k në Ferizaj, është marrëveshje e datës: 06.02.2019, si dhe nuk është marrëveshje e projektit në fjalë dhe nuk është në Original,
- Marrëveshja e furnizimit me Beton e kompanisë COMPANY "BEJTA COMMERCE" SH.A. me kompaninë "Sistem" Sh.p.k, është marrëveshje e datës: 06.02.2019, si dhe nuk është marrëveshje e projektit në fjalë,
- Makineritë që i mungojnë këtij konzorciumi i gjeni si më poshtë: 2 Kamion 1 Finisher Vlen të theksohet se shumica e makinerive të paraqitura nga konzorciumi nuk dallohen dhe nuk shihen mirë,
- Kontratat për 20 punëtor mungojnë, Lista e stafit Profesional i paraqitur nga konzorciumi në fjalë nuk është në rregull dhe ka shumë mungesa si: Inxhinieri i Ndërtimtarisë Muhamet Selimi CV-në nuk e ka në Original siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit. Inxhinieri i Hidroteknikë Skender Ramadani kontrata e punës e paraqitur e tij ka skaduar si dhe CV-n nuk e ka në origjinal. Zija Mezi Inxhinier i Ndërtimtarisë kontrata e punës e paraqitur e tij ka skaduar. Zijadin Kastrati inxhinier i paraqitur i Komunikacionit CV-ia e tij nuk është origjinal dhe nuk është e nënshkruar, si dhe ky person nuk ka kontratë të punës. Kristë Duzhmani Inxhinier i Elektroteknikës, CV-ija e tij nuk është origjinal dhe nuk është e nënshkruar, si dhe ky person nuk ka Kontratë të punës.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Joos&Krasniqi-Bazë" Sh.p.k-Junik duke pretenduar se konzorciumit "N.T.SH, Marash-Shped Sh.p.k & COMPANY "BEJTA COMMERCE'SH.A." i mungon plani dinamik mbi realizimin e projektit, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurim sqaron se AK në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë nuk ka kërkuar dorëzim të Planit Dinamik, por në pikën 17.2 të KVK në dosjen e tenderit AK ka parashikuar 1095 ditë për përfundim të këtij projekti nga data e fillimit të punëve. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Joos&Krasniqi-Bazë" Sh.p.k-Junik duke pretenduar se konzorciumit "N.T.SH, Marash-Shped Sh.p.k & COMPANY "BEJTA COMMERCE'SH.A." i mungon certifikata e biznesit e kompanisë "COMPANY BEJTA COMMERCE" SH.A. sepse është certifikatë e

vjetër dhe nuk është e ndryshuar nga ARBK-ja, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional konstaton se nga AK nuk ka qenë kërkesë e parashtruar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë që certifikatat e biznesit të kompanive të jenë të ndryshuara nga ARBK-ja, andaj pretendimi i OE ankuese nuk qëndron.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Joos&Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik duke pretenduar se konzorciumit “N.T.SH, Marash-Shped Sh.p.k & COMPANY "BEJTA COMMERCE'SH.A.” i mungon sigurimi i tenderit i paraqitur nga ky konzorcium nuk ka të bëjë me këtë Tender, Paneli Shqyrtues sqaron se konzorciumi në fjalë ka bashkangjitur sigurinë e tenderit të lëshuar nga “K SIGKOS” e cila përmban titullin “Ndërtimi i rrugës me asfalt-Kontratë tri vjeçare”, nr. e prokurimit të këtij aktiviteti, vlerën e sigurisë dhe kohëzgjatjen konform kërkesës së parashtruar nga AK me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, ku në këtë sigurim shihet se në vend të emrit “Radoniq” është përdorur fjalia “me asfalt” ky mund të konsiderohet një devijim i vogël, andaj ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Joos&Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik duke pretenduar se konzorciumit “N.T.SH, Marash-Shped Sh.p.k & COMPANY "BEJTA COMMERCE'SH.A.” i mungon ISO PASS 99-2012, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se konzorciumi në fjalë nuk ka bashkangjitur dëshmi për ISO PASS 99-2012. Andaj, ky pretendim ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Joos&Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik duke pretenduar se konzorciumit “N.T.SH, Marash-Shped Sh.p.k & COMPANY "BEJTA COMMERCE'SH.A.” i mungon marrëveshja e furnizimit me Asfalt e kompanisë COMPANY "BEJTA COMMERCE" SH.A. me kompaninë "Rahovica Commerce" Sh.p.k në Ferizaj, është marrëveshje e datës: 06.02.2019, si dhe nuk është marrëveshje e projektit në fjalë dhe nuk është në Original, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se marrëveshjet në fjalë janë lidhur në mes kompanive me qëllim të përkrahjes së kompanisë “Bejta Commerce” sh.a në të gjitha projektet gjatë viti 2019 dhe si të tilla nuk mund të konsiderohen se nuk janë edhe për këtë aktivitet të prokurimit. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Joos&Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik duke pretenduar se konzorciumit “N.T.SH, Marash-Shped Sh.p.k & COMPANY "BEJTA COMMERCE'SH.A.” i mungojnë makineritë: 2 Kamion 1 Finisher Vlen të theksohet se shumica e makinerive të paraqitura nga

konzorciumi nuk dallohen dhe nuk shihen mirë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurim sqaron se konzorciumit në fjalë në listën e makinerive ka specifikuar se posedon 7 kamion dhe 2 finisher mirëpo dëshmitë i ka bashkangjitur vetëm për 4 kamion dhe 1 finisher. Gjithashtu, shumica e dëshmive mbi makinerinë të paraqitura nga konzorciumi nuk dallohen dhe nuk shihen mirë. Andaj, ky pretendim ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Joos&Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik duke pretenduar se konzorciumit “N.T.SH, Marash-Shped Sh.p.k & COMPANY "BEJTA COMMERCE'SH.A.” i mungojnë kontratat për 20 punëtor, Lista e stafit Profesional i paraqitur nga konzorciumi në fjalë nuk është në rregull dhe ka shumë mungesa si: Inxhinieri i Ndërtimtarisë Muhamet Selimi CV-në nuk e ka në Origjinal siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit. Inxhinieri i Hidroteknikë Skender Ramadani kontrata e punës e paraqitur e tij ka skaduar si dhe CV-n nuk e ka në origjinal. Zija Mezi Inxhinier i Ndërtimtarisë kontrata e punës e paraqitur e tij ka skaduar. Zijadin Kastrati inxhinier i paraqitur i Komunikacionit CV-ia e tij nuk është origjinal dhe nuk është e nënshkruar, si dhe ky person nuk ka kontratë te punës. Kristë Duzhmani Inxhinier i Elektroteknikës, CV-ija e tij nuk është origjinal dhe nuk është e nënshkruar, si dhe ky person nuk ka Kontratë të punës. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se AK nuk ka kërkuar që për 20 punëtoreset të paraqiten kontratat por vetëm listën e punëtoreset. Sa i përket listës së stafit profesional si: Inxhinieri i Ndërtimtarisë Muhamet Selimi CV-në nuk e ka në Origjinal siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se ky pretendim nuk qëndron sepse CV e inxhinierit në fjalë është e noterizuar.

Lidhur me inxhinieri i hidroteknik Skender Ramadani se kontrata e punës e paraqitur e tij ka skaduar si dhe CV-n nuk e ka në origjinal, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimi sqaron se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar sepse CV e inxhinierit në fjalë është e nënshkruar ndërsa kontrata e punës i ka skaduar me datën 30.12.2018.

Sa i përket kontratë se Zija Mezi Inxhinier i Ndërtimtarisë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Në lidhje me pretendimin se Zijadin Kastrati inxhinier i paraqitur i Komunikacionit, CV-ia e tij nuk është origjinal dhe nuk është e nënshkruar, si dhe ky person nuk ka kontratë te punës, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se ky pretendim pjesërisht është i bazuar sepse për të njëjtin inxhinier ekziston kontrata me anëtarin e konzorciumit “N.T.SH.Marash-Shped Sh.p.k. Po ashtu, sa i përket pretendimit se Kristë Duzhmani Inxhinier i Elektroteknikës, CV-ija e tij nuk është origjinal dhe nuk është e nënshkruar, si dhe ky person nuk ka Kontratë të punës, Paneli Shqyrtues sqaron se ky pretendim është pjesërisht i bazuar sepse për të njëjtin inxhinier ekziston kontrata me anëtarin e konzorciumit

“N.T.SH.Marash-Shped Sh.p.k.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Joos&Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik duke pretenduar se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 7, par.2 i nenit 24, neni 56, par. 1, 2 dhe 4 i nenit 59, neni 60 dhe par. 6 i nenit 108/A të LPP-së, me arsyetimin se: “Dokumentet të cilat i mungojnë konzorciumit të rekomanduar për dhënie të kontratës N.SH.T. Victory Com & Murseli Sh.p.k janë:

- Vërtetimi nga Administrata Tatimore e Kosovës për të dy Operatorët,
- Certifikata e Gjykatës Ekonomike për të dy Operatorët,
- Vërtetimi i Tatimit në Pronë për të dy Operatorët,
- Deklarate Specifikacioneve Teknike për të dy Operatorët,
- Certifikatat e biznesit këto dy kompani i kane të vjetra, nuk i kane të reja të ndryshuara nga ARBK-ja,
- Këtij Konzorciumi i mungon ISO 9001-2015, ISO e paraqitur nga kompania N.SH.T. Victory Com është iso të cilës i ka skaduar Afati.
- N. SH.T. Victory Com si lider i konzorciumit nuk ka arritur të dëshmojë se ka punë të ngjashme referenca ose Pranime Teknike, 60% të vlerës 750,000.00 Euro në tri vitet e fundit që i bie 450,000.00€,
- Marrëveshja e asfaltit e paraqitur nga kompania N.SH.T. Victory Com me kompaninë Asfaltit Grup është marrëveshja pa datë, pa emër të projektit dhe është marrëveshje vetëm për shfrytëzimin e Licencës, e jo për furnizim me asfalt për projektin në fjalë,
- Marrëveshja për Beton e Gurthyes e paraqitur nga kompania N.SH.T. Victory Com me kompaninë Benita Com është marrëveshja pa datë, pa emër të projektit dhe është marrëveshje vetëm për shfrytëzimin e Licencës, e jo për furnizim me Beton e Zhavor për projektin në fjalë.
- Konzorciumi i rekomanduar për dhënie të kontratës N.SH.T. Victory Com & Murseli Sh.p.k nuk kanë arritur të dëshmojnë se kane staf mjaftueshëm të punëtorëve për kryerjen e punimeve në këtë projekt. Kompania N.SH.T.,
- Victory Com ka paraqitur një Listë prej 20 punëtorëve, kjo kompani njëherësh ka paraqitur edhe një Listë të punëtorëve për vitin 2018, Listë e Cila i përmban vetëm 10 punëtorë dhe të cilët në muajin nëntor e dhjetorë të viti 2018 nuk kanë qenë në punë, Këtyre punëtorëve gjithashtu ju mungojnë edhe kontratat e punës siç janë kërkuar në Dosjen e Tenderit. Lista e Stafit Profesional e këtij Konzorciumi është me shumë probleme: Uran Mulaj, Inxhinier i Komunikacionit nuk e ka

CV-in origjinale të paraqitur as të nënshkruar. Jeton Shasivari, Inxhinier i hidroteknikës është Inxhinier me I (një) vit përvojë pune, nuk ka eksperiencën përvojë pune Siq është kërkuar në dosjen e tenderit. CV-ia e këtij inxhinieri nuk është origjinal as e nënshkruar. Beqë Hadergjonaj, Inxhinier i Ndërtimtarisë i paraqitur nga kompania N.SH.T. Victory Com, kontratën e punës e ka vetëm për aplikime në tenderë e jo për angazhim në këtë projekt. CV-ia e tij nuk është origjinal as e nënshkruar sig kërkohej në FDT. Suad qmega, CV-ja e tij nuk është origjinal as e nënshkruar, si dhe në kontratë të punës ky inxhinier është që nga viti 2017, ndërsa në listen e paraqitur nga ATK-ja ky person në muajin nëntor e dhjetorë nuk ka qene i angazhuar . Inxhinieri i Elektroteknikës z Faton Pylla i paraqitur nga kompania N.SH.T, Victory Com kontratën e punës e ka me validitet të skaduar, po kjo kontratë është kontratë vetëm për pjesëmarrje në tenderë e jo për angazhimin në projektin në Oalë. Këtij inxhinieri i mungon edhe CV-ja,

- Marrëveshja e paraqitur nga kompania N.SH.T. Victory Com me kompaninë Gurbardhi është marrëveshje pa datë, nuk e ka të specifikuar titullin e projektit si dhe specifikacionet mbi makineritë nuk janë të shënuara.
- Marrëveshja e paraqitur nga kompania N.SH.T. Victory Com me kompaninë Rruga ING është marrëveshje pa datë, nuk e ka të specifikuar titullin e projektit si dhe specifikacionet mbi makineritë nuk janë të shënuara.
- Marrëveshja e paraqitur nga kompania N.SH.T Victory Com me kompaninë Mineral L.L.C është marrëveshje pa datë, nuk e ka të specifikuar titullin e projektit si dhe specifikacionet mbi makineritë nuk janë të shënuara.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Joos&Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik duke pretenduar se konzorciumit të rekomanduar për dhënie të kontratës N.SH.T. Victory Com & Murseli Sh.p.k i mungojnë: vërtetimi nga Administrata Tatimore e Kosovës për të dy Operatorët, certifikata e Gjykatës Ekonomike për të dy Operatorët, vërtetimi i tatimit në pronë për të dy operatorët, deklarate e specifikacioneve teknike për të dy operatorët, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se AK kishte kërkuar këto dokumente vetëm nga OE i shpallur fitues, konkretisht nga “N.SH.T. Victory Com & Murseli Sh.p.k” dhe të njëjtat janë dëshmuar nga AK për ekspertin me e-mailin e datës 11.12.2019. Andaj Pretendimi ankimor i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Joos&Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik duke pretenduar se konzorciumi N.SH.T. Victory Com & Murseli Sh.p.k ka dorëzuar certifikatën e biznesit të vjetër dhe nuk është e ndryshuar nga ARBK-ja, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional konstaton se nga AK nuk ka qenë kërkesë e parashtruar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë që certifikatat e biznesit të kompanive të jenë të ndryshuara nga ARBK-ja, andaj pretendimi i OE ankuese nuk qëndron.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Joos&Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik duke pretenduar se konzorciumi N.SH.T. Victory Com & Murseli Sh.p.k i mungon deklaratë mbi specifikacionin teknik, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se në Aneksin 1 të dosjes se tenderit AK ka specifikuar se specifikacioni teknik është dhënë në paramasë, ndërsa grupi OE të rekomanduara për kontratë, e ka dorëzuar paramasen-ofertën financiare të nënshkruar dhe vulosur. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Joos&Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik duke pretenduar se konzorciumi N.SH.T. Victory Com & Murseli Sh.p.k i mungon ISO 9001-2015, ISO e paraqitur nga kompania N.SH.T. Victory Com është iso të cilës i ka skaduar Afati, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se certifikata ISO 9001-2015 e dorëzuar nga konzorciumi N.SH.T. Victory Com & Murseli Sh.p.k ka validitet deri me datën 18.05.2021. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Joos&Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik duke pretenduar se OE N.SH.T. Victory Com si lider i konzorciumit nuk ka arritur të dëshmojë se ka punë të ngjashme, referenca ose Pranime Teknike, 60% të vlerës 750,000.00 Euro në tri vitet e fundit që i bie 450,000.00€, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se ky pretendim ankimor është trajtuar dhe vendosur me Vendimin e PSH nr.448/19 dt.24.09.2019.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Joos&Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik duke pretenduar se marrëveshja e asfaltit e paraqitur nga kompania N.SH.T. Victory Com me kompaninë Asfaltit Grup është marrëveshja pa datë, pa emër të projektit dhe është marrëveshje vetëm për shfrytëzimin e Licencës, e jo për furnizim me asfalt për projektin në fjalë si dhe Marrëveshja për Beton e Gurthyes e paraqitur nga kompania N.SH.T. Victory Com me kompaninë Benita Com është marrëveshja pa datë, pa emër të projektit dhe është marrëveshje vetëm për shfrytëzimin e Licencës, e jo për furnizim me Beton e Zhavor për projektin në fjalë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional konsaton se marrëveshjet në fjalë janë lidhur në mes kompanive me qëllim të përkrahjes së kompanisë N.SH.T. Victory Com në të gjitha projektet dhe si të tilla nuk mund të konsiderohen se nuk janë edhe për këtë aktivitet të prokurimit. Andaj, pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Joos&Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik duke pretenduar se konzorciumi N.SH.T. Victory Com & Murseli Sh.p.k nuk kanë arritur të dëshmojnë se kanë staf të mjaftueshëm të punëtorëve për kryerjen e punimeve në këtë projekt. Kompania N.SH.T. Victory Com ka paraqitur një listë prej 20 punëtorëve, kjo kompani njëherësh ka paraqitur edhe një Listë të punëtorëve për vitin 2018, Listë e Cila i përmban vetëm 10 punëtorë dhe të cilët në muajin nëntor e dhjetorë të viti 2018 nuk kanë

qenë në punë, këtyre punëtorëve gjithashtu ju mungojnë edhe kontratat e punës siç janë kërkuar në Dosjen e Tenderit. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional konsaton se ky pretendim nuk qëndron sepse AK nuk ka kërkuar që për 20 punëtorët të paraqiten kontratat por vetëm listen e punëtorve.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Joos&Krasniqi-Bazë" Sh.p.k-Junik duke pretenduar se konzorciumi N.SH.T. Victory Com & Murseli Sh.p.k se Lista e Stafit Profesional e këtij Konzorciumi është me shumë probleme: Uran Mulaj, Inxhinier i Komunikacionit nuk e ka CV-in origjinale të paraqitur as të nënshkruar. Jeton Shasivari, Inxhinier i hidroteknikës është Inxhinier me 1 (një) vit përvojë pune, nuk ka eksperience përvojë pune Siç është kërkuar në dosjen e tenderit. CV-ia e këtij inxhinieri nuk është origjinal as e nënshkruar. Beqë Hadërgjonaj, Inxhinier i Ndërtimtarisë i paraqitur nga kompania N.SH.T. Victory Com, kontratën e punës e ka vetëm për aplikime në tendera e jo për angazhim në këtë projekt. CV-ia e tij nuk është origjinal as e nënshkruar siç kërkohet në FDT. Suad Qmega, CV-ja e tij nuk është origjinal as e nënshkruar, si dhe në kontratë të punës ky inxhinier është që nga viti 2017, ndërsa në listën e paraqitur nga ATK-ja ky person në muajin nëntor e dhjetorë nuk ka qenë i angazhuar. Inxhinieri i Elektroteknikës z. Faton Pylla i paraqitur nga kompania N.SH.T, Victory Com kontratën e punës e ka me validitet të skaduar, po kjo kontratë është kontratë vetëm për pjesëmarrje në tenderë e jo për angazhimin në projektin në fjalë. Këtij inxhinieri i mungon edhe CV-ja. Lidhur me këto pretendimet të OE ankues, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se AK me rastin e rivlerësimit të ofertave ka kërkuar sqarime nga konzorciumi në fjalë dhe ka pranuar CV-te stafit të nënshkruara të cilat i ka dëshmuar përmes e-mailit të datës 11.12.2019, po ashtu Jeton Shasivari, Inxhinier i hidroteknikës është Inxhinier me 1 (një) vit përvojë pune sepse bazuar në referencën e bashkangjitur nga KUR Gjakova dëshmohet se i njëjti është në marrëdhënie pune nga 01.08.1987, po ashtu kontrata për Inxhinieri e Elektroteknikës z. Faton Pylla kontrata ka qenë valide me rastin e dorëzimit të tenderit sepse hapja është bërë me datën 06.06.2019 ndërsa kontrata në fjalë ka qenë valide deri me datën 28.06.2019. Andaj, këto pretendime ankimore janë të pa bazuara.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Joos&Krasniqi-Bazë" Sh.p.k-Junik duke pretenduar se konzorciumi N.SH.T. Victory Com & Murseli Sh.p.k, duke pretenduar se marrëveshja e paraqitur nga kompania N.SH.T. Victory Com me kompaninë Gurbardhi është marrëveshje pa datë, nuk e ka të specifikuar titullin e projektit si dhe specifikacionet mbi makineritë nuk janë të shënuara, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se në këtë marrëveshje janë cekur pajisjet dy ngarkues me peshë mbi 10t.

Marrëveshja e paraqitur nga kompania N.SH.T. Victory Com me kompaninë Rruga ING është marrëveshje pa datë, nuk e ka të specifikuar titullin e projektit si dhe specifikacionet mbi makineritë nuk

janë të shënuara, në këtë marrëveshje janë cekur pajisjet dy finisher, cilindra dhe rule 3 cope, kompresor ajri 1 cope, pres asfalti 1 cope dhe papuqe për ngjeshje 1 cope.

Marrëveshja e paraqitur nga kompania N.SH.T Victory Com me kompaninë Mineral L.L.C është marrëveshje pa datë, nuk e ka të specifikuar titullin e projektit si dhe specifikacionet mbi makineritë nuk janë të shënuara, në këtë marrëveshje janë cekur pajisjet Garder, Finisher, bydHndradhe rule ngjeshes, 3 eskavator me peshe totale minimum 4-13 t, sidhe 4 kamiona me konstruksion ndertimi kipper mbi 10t. Andaj, këto pretendime ankimore janë të pa bazuara sepse në marrëveshjet e larte cekura janë specifikuar pajisjet si dhe të njëjtat janë nënshkruar dhe vulosur nga kompanitë në fjale me qëllim të shfrytëzimit të pajisjeve në implemetnimit e projekteve sipas nevojave të N.SH.T Victory Com.

Lidhur me pretendimi e OE ankuese se AK ka bërë shkelje të nenit 60 të LPP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional konsaton se ky pretendim nuk qendron sepse konzorciumi i rekomanduar nga AK për dhënie të kontrates “N.SH.T. Victory Com & Murseli Sh.p.k” përmban ofertë me vlerë finaciare prej 308,074.75 €, e cila është më e lirë në vlerë prej 71,823.75 €, se sa oferta me vlerë finaciare prej 379,898.50 € e OE ankues.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 28, 52, 69 dhe par.1 dhe 2 të nenit 80 të LPP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional konsaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk janë të bazuara sepse OE ankuese pretendimet në fjale vetëm i ka cekur sipërfaqsisht pa sqaruar dhe pa dhënë ndonjë fakt rreth shkeljes së ketyre nenëve në deklaratën e ankesës së dorëzuar po ashtu më nenët 28, 52, 69 dhe par.1 dhe 2 të nenit 80 të LPP-së rregullohen respektivisht udhëzohen autoritetet kontraktuese se si duhet të vendosen në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë specifikacionin teknik, njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës, kërkesat minimale dhe dëshmit që duhet të dorëzohen lidhur me aftësit teknike dhe/ose profesionale, si dhe si duhet të formohet juria dhe si duhet të merren vendimet nga juria, gjatë ushtrimit/zhvillimit të një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues vije në përfundim se në rastin konkret AK ka vepruar konform nenit 59.4 ku thuhet se: *Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmeri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontrates dhe në dosjen e tenderit. Pavaresisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në*

njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, në shkresat e lëndës të cilat i ka pas në dispozicion si dhe në sqarimet e ekspertit profesional të prokurimit, Paneli shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, konform nenit 60 të LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, një kohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, ndërsa autoriteti kontraktues në këtë rast ka vepruar konform këtij neni. Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka marrë parasysh dhe ka vepruar duke pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, me transparente dhe me të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- Komuna Gjakovë
- 1x1 OE - "Joos&Krasniqi-Bazë" Sh.p.k-Junik
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

